

A kam të drejtë të ankoem për shkeljen e të drejtave të mia?

- e drejta e ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave,
- e drejta për informim në lidhje me ecurinë e çështjes,
- e drejta e përfitimit të shërbimit ligjor falas, etj.

Po, ju keni të drejtë të ankoheni nëse këto të drejta shkelen nga avokatet e Qendrës së Ndihmës Ligjore Falas, Durrës ose avokatet e QNL-së në Tiranë.

Ju mund të na telefononi në nr. 00355 67 27 54 655 ose të na shkruani në adresën e emailit avokatore2@yahoo.com

Një kuti ankesash është e vendosur pranë Qendrës së Ndihmës Ligjore Falas në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës si dhe në ambientet e QNL-së. Ankesat do të administrohen me kujdes nga drejtuesit e QNL-së, me qëllim zgjidhjen e ankesës.

Çdo avokate që do t'ju ofrojë shërbim garanton ruajtjen konfidenciale të të dhënave tuaja personale.

Për të përfituar shërbim ligjor falas, Drejtohuni pranë Qendrës së Ndihmës Ligjore Falas pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në adresën e mëposhtme: Lagja Nr.2, Rruga: “Aleksandër Goga”, Durrës

ose në QNL në adresën: Rruga “Vaso Pasha”, P.12,Shk.1, Ap.1, Tiranë.

Për të përfituar shërbim ligjor falas ju mund të na telefononi në numrat:

- ☎ Cel: 00355 69 47 85 340;
- ☎ Cel: 00355 68 58 27 370;
- ☎ Cel: 00355 67 27 54 655;

Ju mund të na shkruani edhe në faqen e web:

🌐 www.qag-al.org

në rubrikën pyetje për avokatin ose në adresën e emailit:

✉ avokatore@albmail.com
avokatore2@yahoo.com

Ju mirëpresim!



Qendra e Ndihmës Ligjore Falas



Ndihmë juridike për individët në nevojë në Qendrën e Ndihmës Ligjore Falas pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

Kjo fletëpalosje është përgatitur në kuadrin e zbatimit të projektit “Fuqizimi i grupeve të varfra dhe të marginalizuara përmes ofrimit të ndihmës juridike falas dhe edukimit ligjor, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës”, me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim PNUD dhe fonde të Qeverisë së Turqisë.

Qendra e Ndihmës Ligjore Falas



Empowered lives
Resilient nations.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) është një organizatë jofitimprurëse që ofron ndihmë ligjore falas për shtresat në nevojë.

Një Qendër e Ndhmës Ligjore Falas funksionon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor në Durrës. Dy avokate të QNL-së, të specializuara në fushën e të drejtave të njeriut, ju ofrojnë këshillime e përfaqësime ligjore Falas.

Kush mund të përfitojë shërbim ligjor falas?

Çdo individ me të ardhura të ulëta, që ka nevojë për shërbimin ligjor dhe nuk ka mundësi të marrë një avokat, mund të drejtohet pranë kësaj Qendre.

Individë dhe/ose grupe nga komuniteti rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara, komuniteti LGBTI, persona të moshuar dhe grupe të tjera vulnerable, do të përfitojnë nga shërbimet tona me përparësi;

Si mund të gjeni vendndodhjen e Zyrës së Ndhmës Ligjore Falas?

Qendra ndodhet në mjediset e brendshme të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Kati i Parë.

Çfarë shërbimesh mund të përfitoni pranë Qendrës së Ndhmës Ligjore Falas në Durrës?

Ju mund të përfitoni:

- informim mbi të drejtat dhe mjetet ligjore;
- konsultim mbi çështjen tuaj ligjore;
- përgatitjen e kërkesave, ankesave dhe dokumenteve të tjera ligjore;
- Këshillim në lidhje me procesin;
- Këshillim për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve;
- mbështetje dhe referim për ndërmjetësim;
- përfaqësim ligjor në çështjet gjyqësore civile;
- përfaqësim ligjor në çështjet gjyqësore administrative;
- përfaqësim në institucionet shtetërore administrative;
- Mbështetje dhe përfaqësim për çështjet penale;

Qytetarë!

Nëse keni nevojë për shërbim ligjor falas, për çështje familjare, civile, administrative, penale, çështje të mbrojtjes nga dhuna në marrëdhëniet familjare ose çështje të tjera ligjore, drejtohuni në Qendrën e Ndhmës Ligjore Falas pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor në Durrës.

Qendra e Ndhmës Ligjore Falas ofron mbështetje të veçantë për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Avokatet e Qendrës do të bashkëpunojnë ngushtësisht me institucionet përgjegjëse në Durrës, pjesë e Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje, për referimin dhe menaxhimin e rastit.

Avokatet e Qendrës së Ndhmës Ligjore Falas janë të specializuara në çështje të diskriminimit për shkak të moshës, etnisë, racës, ngjyrës, aftësive të kufizuara, orientimit seksual, etj., dhe do të ofrojnë ndihmë ligjore për ju.

A duhet të paraqes dokumente për të përfituar shërbimin ligjor falas?

Ju duhet të paraqisni vetëm një fotokopje të kartës së identitetit (ose të dokumentit të identifikimit) dhe dokumentacionin që posedoni për çështjen tuaj.

Vini re!

Shërbimi ligjor pranë Qendrës së Ndhmës Ligjore në Durrës dhe QNL-së, në Tiranë, ofrohet falas.